



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:247539
Datë: 15.07.2024
Numri i dokumentit: 05937553

Ac.nr.4547/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.SH.H nga Komuna e Obiliqit, me vendbanim në Prishtinë, Lagjja, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë avokatët S.M dhe K.M – të dy me seli të përbashkët të zyrës në Prishtinë, Rr., kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.A. me seli në Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë, Nr. 36 për kompensimin e dëmit për shkak të mos shfrytëzimit të paluajtshmërive, duke vendosur sipas ankesës tsw ë paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.2375/13, i datës 16.04.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 04.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.A. me seli në Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë, Nr. 36, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.2375/13, i datës 16.04.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.2375/13, i datës 16.04.2021, ka vendosur si në vijim:

- 1. “APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit R.SH.H nga Komuna e Obiliqit për kompensimin e dëmit nga mosshfytëzimi i paluajtshmërive për mbjellje të kulturave bujqësore, të shkaktuar nga ana e të paditurës, për parcelat si në vijim:*

- 1.1. P-...0, Zona Kadastrale Obiliq, parcelë – pronë private, vendi i quajtur “Kajnak” me sipërfaqe 8205m², Livadh i klasës II, pjesa e pronës së paditësit ½;
 - 1.2. P-.....-0, Zona Kadastrale Obiliq, parcelë – pronë private, vendi i quajtur “Karmak” me sipërfaqe 7041m², Livadh i klasës II, pronë e paditësit 1/1;
 - 1.3. P-....-1, Zona Kadastrale Obiliq, parcelë – pronë private, vendi i quajtur “Novi Obiliq” me sipërfaqe 3396m², Livadh i klasës II, pronë e paditësit 1/1;
 - 1.4. P-....-0, Zona Kadastrale Obiliq, parcelë – pronë private, vendi i quajtur “Kajnak” me sipërfaqe 9288m², Arë e klasës II, pronë e paditësit 1/1;
 - 1.5. P-....-1, Zona Kadastrale Obiliq, parcelë – pronë private, vendi i quajtur “Kajnak” me sipërfaqe 1541m², Kullosë e klasës I, pronë e paditësit 1/1;
 - 1.6. P-....-0, Zona Kadastrale Obiliq, parcelë – pronë private, vendi i quajtur “Kajnak” me sipërfaqe 4934m², Arë e klasës II dhe Livadh i klasës II, pronë e paditësit 1/1;
2. *DETYROHET e Paditura Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.A. që në emër të kompensimit të dëmit t’ia paguajë paditësit periudhën e mbjelljes dhe vjeljeve në vitet 2010 – 2020 shumën 24’262.75€ me kamatëvonesë, dhe atë:*
- 2.1. *Për vitet 2010 – 2012 si për mjetet e depozituara mbi një vit pa destinim të caktuar në ndonjërin nga bankat;*
 - 2.2. *Për vitet 2013 – 2020 në lartësi 8%,*
- të gjitha këto prej ditës së parashtrimit të padisë 18.09.2013 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga data e pranimit këtij Aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.*
3. *Obligohet e paditura KEK që paditësit t’ia paguajë shumën 2’930.40€, në emër të shpenzimeve të procedurës të shkaktuara nga ky kontest, në afat prej 15 ditësh nga data e pranimit këtij Aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.”*

Kundër këtij Aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovet si e bazuar ndërsa aktgjykimi të ndryshohet dhe kërkesëpadia të refuzohet e pa bazuar.

Pala paditëse nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si Gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi me datë 18.09.2013 ka paraqitur padi kundër të paditurës, me objekt të padisë për kompensimin e dëmit material, me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave dhe vlerësimit të plotë të gjendjes faktike ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.2375/13, i datës 16.04.2021 me të cilin është aprovuar si e bazuar në tërësi kërkesëpadija e paditësit më gjerësisht si në dispozitiv dhe arsyetim të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës parë në arsyetim të aktgjyimit ka theksuar se pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës prove veç e veç dhe të gjithave së bashku, në bazë të çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar në tërësi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Tutje ka shtuar se nga provat e administruara, gjegjësisht nga Ekspertiza gjeodezike – plotësimi i saj (Prova nr. 3 dhe 5), pas identifikimit dhe verifikimit të dokumentacionit, sipas evidencës në elaboratin kadastral, kontesti gjyqësor ka të bëjë me kompensimin e dëmit të paditësit në paluajtshmëritë e tij të cilat evidentohen në Zonën Kadastrale Obiliq, e tutje sipas ekspertizës, e paditura me rastin e ndërtimit të kanalit për rrjedhje të ujit të termocentralit “Kosova A” kishte ndarë ngastrat kasdastrale 993-0, 1034-0 dhe 1036-1 në dy pjesë por që matjet gjeodezike nuk janë bërë për shkak të kushteve të papërshtatshme.

Gjykata e shkallës së parë ka shtuar se sipas gjendjes faktike në terren në ditën e daljes në vendshiqim është konstatuar se një kompleks i gjerë i ngastrave të ZK Obiliq ka probleme me vërshime të ujit nga lumi Sitnica sepse me rregullimin e shtratit të ujit është ngritur bankina mbrojtëse ndërsa sipas matjeve konstatohet se kuota e bankinës mbrojtëse është më e lartë sesa kuota e një kompleksi të madh të ngastrave – ndryshim ky i shprehur në lartësi 4.10 metra në anën perëndimore të ngastrave lëndore. Sipas matjeve, në anën lindore të ngastrave konstatohet se diferenca në kuotë të ngastra është 1.46 metra më e ultë sesa niveli i hekurudhave të Kosovës të cilat shtrihen përgjatë anës lindore. Gjykata më tej ka konstatuar në bazë të ekspertizës gjeodezike dhe të gjeturave pas daljes në terren se paluajtshmëritë e paditësit – të gjitha ngastrat lëndore kanë sipërfaqe të konsiderueshme të cilat nuk mund të shfrytëzohen nga paditësi dhe atë: Në parcelën 00993-0 është i pamundur shfrytëzimi i sipërfaqes 3742m² nga 8205m²; Në parcelën 01034-0 është i pamundur shfrytëzimi i sipërfaqes 2136m² nga 7041m², Në parcelën 01036-1 është i pamundur shfrytëzimi i sipërfaqes 893m² nga 3396m², në parcelën 01059-0, shfrytëzimi i paluajtshmërisë së paditësit është i pjesërishëm, ndërkaq parcelat 1045-0 dhe 1046-1 janë të mbuluara nga bari dhe të kositura - siç është konstatuar në ditën e daljes në vendshiqim nga eksperti i gjeodezisë Qemajl Hoda, datë 15.07.2019.

Sipas Gjykatës së shkallës së parë nga ekspertiza e ujërave, gjegjësisht nga plotësimi/sqarimi i mendimit të ekspertit A.GJ i dhënë lidhur me kontestin e palëve ndërgjyqëse, (Prova nr. 2 dhe 6), Gjykata ka konstatuar se paditura me ndërhyrjet të cilat i ka bërë në shtratin e lumit Sitnica

dhe ndërtimin e kanalit për zbrazjen / derdhjen e ujërave nga aktiviteti i saj ekonomik, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion teknik apo pëlqim me të cilën do të trajtonte largimin e ujërave teknologjike dhe ndotjeve të ajrit me të cilat janë formuar shirat acidike dhe janë derdhur në palujatshmëritë e paditësit. Sipas ekspertit, pas elaborimeve e studimeve të bëra, gjykata ka konstatuar se e paditura nuk ka dëshmuar se i mirëmban kanalet për largimin e ujërave të cilat i ka ndërtuar vet – e rrjedhimisht me këtë konstatohet përgjegjësia e të paditurës për shkaktimin e dëmit në palujatshmëritë e paditësit, siç është pretenduar nga ky i fundit, duke i pamundësuar kështu të njëjtit shfrytëzimin e lirë të parcelave për mbjellje të kulturave bujqësore. Shtuar këtyre sqarimeve, në bazë të kësaj ekspertize gjykata konstaton se e paditura nuk është pajisur me pëlqim dhe leje të parapara me dispozitat ligjore të zbatuara tek organi kompetent shtetëror i ujërave sa i përket ndërtimit të objekteve elektroenergjetike të “Kosova A”.

Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se meqë e paditura nuk prezantoi prova mbështetëse për t’i kundërshtuar konstatimet nga ekspertiza e ujërave, në bazë të elaborimeve të lartëcekura, si dhe në bazë të nenit 136 dhe 137 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, gjykata i fali besimin pretendimeve të palëve paditëse dhe ekspertizave të kryera, për çka e aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, dhe për këtë vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi. Lidhur me lartësinë e kompensimit të dëmit të shkaktuar nga ana e të paditurës ndaj paditësit konkretisht vlerësimi i aspektit agro-ekonomik të dëmit, gjykata ka marrë për bazë të gjeturat nga ekspertiza bujqësore (Prova nr. 4, 7 dhe 8), gjegjësisht plotësimet përkatëse të dorëzuara gjykatës gjatë zhvillimit të procedurës.

Tutje ka shtuar se në bazë të kërkesës së paditësit, të precizuar për nga aspekti kohor (me parashtrësë të veçantë) dhe për nga lloji i kulturave bujqësore, kulturat bujqësore të cilat u morën për bazë gjatë llogaritjeve janë përpiluar ashtu nga katalogu i prodhimeve bujqësore të grurit kokërr, misrit kokërr pa ujitje, misrit sillazhor pa ujitje, fasules së kombinuar me misër, dhe kungujt. Kostot e prodhimit dhe fitimin për secilën kulturë veç e veç dhe sipas një qarkullimi bujqësor për vitet 2010 - 2020 i janë bashkëngjitur plotësimet të dytë të ekspertizës bujqësore (Prova nr. 8), sipas të cilës gjykata ka konstatuar se paditësi ka pësuar humbje totale në vlerën 24’262.75€. në nxjerrjen e kësaj shumë, eksperti bujqësor ka sqaruar sa nga kalkulimet e përgjithshme ka minusuar vlerën 25% nga shfrytëzimi i një rendimenti të pjesshëm, varësisht nga vitet me thatësi, dhe kur sasia e ujërave është larguar gjatë vegjetacionit.

Për gjykatën e shkallës së parë, ekspertiza bujqësore me plotësimet e saj vërteton se paditësit i është shkaktuar dëmi në vlerën financiare të elaboruar si më lartë, dhe mendimi i ekspertit të bujqësisë ka demonstruar se vlerësimi i kulturave ka qenë real për kulturat e përshkruara si në par. 17 të këtij aktgjykimi, ndërsa planifikimi i cili do gjente realizim ndër vitet 2010 – 2020 kap vlerën 24’262.75€. Në bazë të elaborimeve të lartëcekura dhe në frymën e zhvillimit të përgjithshëm të procedurës gjyqësore dhe arsytimit të tërësishëm të këtij aktgjykimi, Gjykata e ka caktuar lartësinë e kompensimit të dëmit nga mosshfrytëzimi i palujatshmërive të si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për kamatëvonesën, gjykata vendosi në pajtim me dispozitat e zbatuara nga Ligji mbi detyrimet i vitit 1978 për periudhën 2010 – 2012, si dhe në bazë të nenit 382 të Ligjit për marrëdhëniet e

detyrimeve për periudhën 2013 - 2020, duke marrë për bazë mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës datë 02.12.2020, pjesa III, nr. XIV, për çka e caktoi llogaritjen e kamatës nga momenti i parashtrimit të padisë 18.09.2013 e deri në pagesën defintive.

Në lidhje me afatin e përmbushjes vullnetare të detyrimit sipas këtij Aktgjykimi si dhe afatin për paraqitje të Ankesës – prej 15 ditësh, Gjykata vendosi bazuar në nenin 146 dhe 176 të LPK-së.

Vendimin për aprovimin e kërkesës për shpenzimet e shkaktuara në këtë procedurë, gjykata e bazoi në nenin 452 par. 1 të Ligjit për procedurën kontestimore,

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, e aprovon në tërësi vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 tëLPK-së gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht si dhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore të parashtruara nga ana e palës së paditur, në raport me shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, Gjykata e Apelit vlerëson se nuk ekzistojnë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 i LPK-së ashtu siç ka pretenduar pala e paditur në ankesë, pasi që Gjykata e shkallës së parë me përpikëri i ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore duke i vlerësuar të gjitha provat të cilat palët ndërgjyqëse i kanë propozuar si dhe duke arsyetuar se cilat prova i ka administruar si dhe cilat fakte i ka vërtetuar me anë të këtyre provave, kështu duke ardhur në përfundimin e drejtë dhe të ligjshëm se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë pasi që gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe se nga provat e administruara pa dyshim është vërtetuar se e paditura i ka shkaktuar dëm paditësit në paluajtshmëritë e tij kështu që me veprimet e të paditurës, paditësi nuk mund ti shfrytëzoj këto parcela duke mos mundur që të kultivoj asgjë në to. Për të vërtetuar faktin se paditësit i është shkaktuar dëmi i pretenduar, Gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë ekspertizën e gjeodezisë, ekspertizën e bujqësisë si dhe ekspertizën e ujërave.

Nga ekspertiza e gjeodezisë është vërtetuar se pas daljes në terren në paluajtshmëritë e paditësit të gjitha ngastrat lëndor nuk mund të shfrytëzohen nga ana e paditësit, ndërsa nga ekspertiza e ujërave është konstatuar se e paditura me ndërhyrjet të cilat i ka bërë në shtratin e lumit Sitnica dhe ndërtimit e kanalit për zbrazjen/derdhjen e ujërave nga aktiviteti i saj ekonomik, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion teknik apo pëlqim me të cilën do të trajtonte largimin e ujërave teknologjike dhe ndotjeve të ajrit me të cilat janë formuar shirat acidike dhe janë derdhur në paluajtshmëritë e paditësit. Kurse nga ekspertiza e bujqësisë ka rezultuar të provohet se si rezultat i pamundësisë së mbjelljes së këtyre paluajtshmërive paditësi ka pësuar dëm në vlerë prej 24,262.75 euro.

Ekspertizat në fjalë i pranon edhe Gjykata e Apelit si të besueshme, objektive të punuara në mënyrë profesionale si dhe në përputhje edhe me shkresat e tjera të lëndës, ashtu që në këtë kuptim, kjo Gjykatë vlerëson se drejtë është vërtetuar gjendja faktike si dhe drejtë është vendosur nga ana e Gjykatës së shkallës së parë kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Në raport me të drejtën materiale, Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar është marrë me zbatim të drejtë të së drejtës materiale, pasi që me nenin 140 të LMD-së përcaktohet se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia. ”* Pala paditëse ka provuar se është dëmtuar si rezultat i ndërhyrjeve të cilat i ka bërë e paditura në shtratin e lumit Sitnica dhe ndërtimit e kanalit për zbrazjen/derdhjen e ujërave nga aktiviteti i saj ekonomik, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion teknik apo pëlqim me të cilën do të trajtonte largimin e ujërave teknologjike dhe ndotjeve të ajrit me të cilat janë formuar shirat acidike dhe janë derdhur në paluajtshmëritë e paditësit.

Me nenin 136 të LMD-së përcaktohet se: *“1. Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. 2. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji..”*

Ndërsa neni 169 i LMD-së përcakton se: *“1. Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. 2. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. 3. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t`ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. 4. Gjykata do t`i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme.*

Në rastin konkret, nga të gjitha provat e administruara pa dyshim është vërtetuar fakti se paditësit i është shkaktuar dëm në paluajtshmëritë e tij si rezultat i ndërhyrjeve nga ana e të paditurës dhe si pasojë e këtyre veprimeve paditësit i është pa mundur që këto toka ti mbjellë andaj rrjedhimisht meqenëse është shkaktuar dëmi atëherë, rrjedh edhe përgjegjësia e të paditurës që këtë dëm ta kompensojë meqenëse rivendosja e gjendjes së mëparshme në rastin konkret nuk është e mundur.

Duke pasur parasysh faktin se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Vendimi lidhur me kamatën është marrë dispozitave ligjore te nenit 186 lidhur me nenin 277 te LMD-së për periudhën 2010 – 2012, si dhe në bazë të nenit 382 të Ligjit për Mmarrëdhëniet e Detyrimeve për periudhën 2013 - 2020, duke marrë për bazë mendimin juridik te Gjykatës

Supreme të Kosovës datë 02.12.2020, pjesa III, nr. XIV, për çka e caktoi llogaritjen e kamatës nga momenti i parashtrimit të padisë 18.09.2013 e deri në pagesën defintive.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata drejtë ka vendos drejtë edhe në raport me shpenzimet e procedurës kontestimore, bazuar në nenin 452 të LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 pika (d) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4547/2021, datë 04.07.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.